

# Proçedura e thjeshtuar e azilit

Ju vini nga një vend i sigurt, ose ju tashmë keni mbrojtje ndërkombëtare në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian

## **Perse ju jepet ky botim?**

Ju deshironi të kerkoni azil në Holland. Azil do të thotë: mbrojtje - per persona të cilet nuk janë të sigurt në vendin e tyre dhe atje - nuk mund të gjejne mbrojtje.

Kur beni kerkese për azil, atëherë ju i kerkoni qeverise së Hollandës një leje qëndrimi. Kjo leje qëndrimi ju nevojitet per të banuar dhe punuar në Holland.

Pasi ju të keni paraqitur kërkesën tuaj për azil, hapet proçedura e azilit: një proçedurë juridike në të cilat qeveria holandeze shqyrton - nëse ju japin një leje qëndrimi.

Në këtë botim lexoni se çfarë ndodh gjatë kësaj procedure të azilit. Ju lexoni gjithashtu çfarë duhet të bëni (detyrimet tuaja) dhe çfarë mund të prisni - nga qeveria holandeze (të drejtat tuaja).

## Kur merrni një leje qëndrimi për azil?

Në legjislacionin hollandez për të huajt përshkruhen kushtet që duhen plotësuar për të marrë një leje qëndrimi për azil. Ju mund të merrni një leje qëndrimi nëse:

- ju keni arsye legjitime t'i frikësoheni përndjekjes në vendin tuaj të prejardhjes për shkak të racës, fesë, shtetësisë, bindjeve politike ose sepse ju i përkisni një grupi të caktuar shoqëror ose;
- ju keni arsye legjitime në vendin tuaj të prejardhjes të keni frikën e denimit me vdekje apo ekzekutimit, torturimit ose një tjetër formë trajtimi çnjerezor ose poshterues ose;
- ju keni arsye legjitime të frikësoheni se do të beheni viktimë e
- dhunës së rastit si pasojë e një konflikti të armatosur në vendin tuaj të prejardhjes ose;
- bashkëshorti / bashkëshortja juaj, partneri/a, nëna, babai ose fëmija juaj nënmoshë ka marrë kohët e fundit një leje qëndrimi për azil në Holandë.

Sepse ju vini nga një vend i prejardhjes i sigurt, ose ju tashmë gezoni mbrojtje ndërkombëtare në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, ka shumë mundësi që IND-ja të arrij në përfundimin që ju nuk i plotësoni këto kushte. Prandaj, kërkesa juaj për azil shqyrtohet në formë të thjeshtuar dhe të përshpejtuar.

## Lista e shteteve të sigurta

Shqipëri, Algjeri, Andorrë, Australi, Austri, Belgjikë, Bosnje-Hercegovinë, Brazil, Bullgari, Kanada, Kroaci, Qipro, Republika Çeke, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Gjeorgji, Gjermani, Ganë, Greqi, Hungari, Islandë, Irlandë, Indi, Itali, Xhamajkë, Japoni, Kosovë, Letoni, Lihtenshtajn, Lituani, Luksemburg, Maqedoni, Maltë, Marok, Monako, Mongoli, Mali i Zi, Holandë, Zelanda e Re, Norvegji, Poloni, Portugali, Rumani, San Marino, Senegal, Serbi, Sllovakia, Slloveni, Spanjë, Suedi, Zvicër, Togo, Trinidad dhe Tobago, Tunizi, Ukrainë, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara, Qyteti i Vatikanit

*Kjo listë është objekt i ndryshimeve; shtetet mund të shtohen ose të hiqen në varësi të situatës së sigurisë në një shtet.*

## Me cilat organizata do keni të beni?



COA Centraal Orgaan opvang asielzoekers

Organi **Qendror i strehimit të azilkërkuesve (COA)** kujdeset për strehimin dhe udheheqjen e qendrimit rreth procedurës së azilit të azilkërkuesve në Holandë. COA-ja pergjigjet për strehimin tuaj, ushqimin dhe për kujdesin e nevojshëm mjekësor. Bashkëpunëtorët e COA-së ju mbështesin në zgjedhjet tuaja në lidhje me të ardhmen tuaj. COA-ja është një organizatë e pavarur dhe nuk vendos mbi kërkesën tuaj për azil.



**Vluchtelingenwerk Nederland** është një organizatë e pavarur e të drejtave të njeriut e themeluar për të mbrojtur të drejtat e azilkërkuesve. Vluchtelingenwerk ju jep informacion dhe shpjegime lidhur me procedurën e azilit. Vluchtelingenwerk ju informon dhe ju mbështet personalisht gjatë kalimit të kesaj procedure dhe ndërmjetësonte rast problemesh me organizata të tjera. Në këtë ata punojnë ngushtë me avokatin tuaj. Vluchtelingenwerk gjithashtu nuk vendos mbi kërkesën tuaj për azil.

## Raad voor Rechtsbijstand *legal aid*

Keshilli i **Ndihmës Juridike kujdeset** që ju të merrni ndihmë nga një avokat, nëse ju nuk mund ta paguani vetë atë. Keshilli i Ndihmës Juridike i paguan avokatit shperblimin për ndndihmen që ai iu ka dhënë ju. Avokati nuk është i punësuar nga Keshilli i Ndihmës Juridike. Avokati është një ofruer i pavarur i ndihmes juridike që ju mbështet në procedurën e azilit, por ai nuk vendos mbi kërkesën tuaj për azil.



### Departamenti i Identifikimit dhe i Trafikut Human

(DHIF) është pjesë e Policisë Nacionale së të Huajve. DHIF është përgjegjëse për konstatimin dhe regjistrimin e identitetit tuaj. Për këtë qëllim, ata ju kontrollojnë bagazhin, ju bëjnë kontroll trupor, ju kërkojnë të dhënat tuaja personale dhe dokumentet, ju bëjnë gjithashtu një foto dhe ju marrin shenjat e gishtave. Përveç kësaj, (DHIF) është përgjegjëse për sigurimin tuaj.



Immigratie- en Naturalisatiedienst  
Ministerie van Veiligheid en Justitie

Sherbimi i **Emigracionit dhe Natyralizimit (IND)** është pjesë e Ministrisë Holandeze të Drejtësisë dhe Sigurisë. Punonjësit e IND zhvillojnë biseda me ju rreth identitetit tuaj, shtetësië, rrugës së udhëtimit dhe për arsyet e largimit nga vendi juaj. Ata hetojnë historinë tuaj personale dhe situatën në vendin tuaj të prejardhjes. Më pas ata vendosin nëse ju (paraprakisht) mund të qëndrojnë në Holandë, ose që ju duhet të ktheheni në vendin tuaj.



Në mjediset e IND-s dhe qendrave të strehimit të-s COA janë punonjes të sigurisë të **pranishëm**. Ju do t'i dalloni ata nga uniformat e tyre. Ata janë për sigurinë tuaj. Ju mund t'i beni pyetje rojeve lidhur me atë që është e lejuar ose jo në ndërtesat dhe në mjediset e IND-s dhe të COA-s. Punonjësit e sigurimit nuk ndikojnë në vendimin mbi kërkesën tuaj për azil.



Dienst Terugkeer en Vertrek  
Ministerie van Veiligheid en Justitie

**Sherbimi i Kthimit dhe Largimit (DT&V)** është pjesë e Ministrisë Holandeze të Drejtësisë dhe Sigurisë. Nëse IND e refuzon kërkesën tuaj për azil, një punonjës i DT&V mund t'ju mbështesin në kthimin tuaj vullnetar në vendin tuaj të prejardhjes. Nëse ju nuk largoheni vullnetarisht nga Holanda, atehere DT&V mund të kalojë në kthimin tuaj të detyruar.



**Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM)** është një organizatë e pavarur që mbështet migrantët në shkallë botërore. IOM mund të ju ndihmojë nëse ju dëshironi të largoheni në mënyrë të pavarur nga Holanda. IOM ju jep informacion mbi kthimin dhe ri-integrimin dhe ju ndihmon për të organizuar largimin tuaj nga Holanda. Ju mund t'i kërkonit VluchtelingenWerk ose avokatit tuaj për t'ju ndihmuar në këtë.

## Çfarë pritet nga ju?

Gjatë procedurës, ju duhet të shpjegoni arsyet pse kerkoni azil në Hollandë. Është e rëndësishme që jepni deklaratat të hollësishme që tregojnë se pikerisht ju keni nevojë për mbrojtje. Gjithashtu, ju duhet t'i tregoni IND-s të gjitha dokumentet që mbështesin deklaratat tuaja. Për shembull, dokumentat e identitetit ose letra.


Keni rrethana personale të cilat IND duhet t'i marrë parasysh? Këtë mund ta bëni të ditur tek VluchtelingenWerk, ose gjatë intervistës me IND-n. IND -ja atëherë mund të marrë masa, për shembull gjatë intervistave apo në strehim tek COA. IND-ja përpiqet t'ju mbështesë sa më mirë të jetë e mundur duke marrë parasysh kushtet tuaja personale.

## Procedura juaj e azilit nga hap për hap

Më poshtë janë të përshkruara të gjitha hapat që ju do ndiqni gjatë procedurës së azilit. Për shkak se ju vini nga një vend që nga qeveria holandeze konsiderohet si një vend i sigurt, INDe shqyrton kërkesën tuaj për azil brenda një procedure të thjeshtuar.

Gjatë procedurës së azilit, ka mundësi të qendroni në të njëjtën qendër strehimi si ku dhe qëndruat gjatë fazës së përgatitjes për procedurën. Intervistat me IND-n do të mbahet në zyrat e IND-s.

Më poshtë do të lexoni se si zhvillohet procedura juaj për azil.



### Hapi 1: Regjistrimi tek-ja IND

Ju jeni paraqitur tek IND-ja në Ter Apel. Personeli i IND-së ju kanë regjistruar dhe tani jeni në pritje të paraqitjes së kërkesës tuaj për azil.

### Hapi 2: Formulari i regjistrimit

Ju keni plotësuar një formular të regjistrimit që përmban informacion lidhur me ju. Kjo ndihmon IND-në që të bëjë një lloj vlerësimi të situatës suaj, gjë e cila do të mbahet parasysh në procedurën tuaj të azilit. Të dhënat që ju keni plotësuar në formularin e regjistrimit përdoren nga IND-ja si pikënisje në zhvillimin e mëtejshëm të procedurës së azilit.

### Hapi 3: Identifikimi / Regjistrimi nga Policia për të Huajt (AVIM)

Ju jeni paraqitur edhe tek Policia për të huajt. Ata ju kanë identifikuar dhe regjistruar dhe tek ata ju keni nënshkruar kërkesën tuaj për azil, në mënyrë që IND-ja të mund të shqyrtojë kërkesën tuaj për azil.

### Hapi 4: Përcaktimi i Procedurës nga IND-ja

Në bazë të informacionit nga hapi 1, 2 dhe 3, IND-ja vendos se në cilën procedurë të azilit (në cilin drejtim) do të shqyrtohet kërkesa juaj për azil. Gjatë shqyrtimit të kërkesës tuaj për azil mund të rezultojë që kërkesa juaj gjithësesi duhet të trajtohet në një drejtim procedurë tjetër, ku si pasojë ju kërkohet ndërrimi i procedurës. Atëherë ju japin një prospekt tjetër, ku shpjegohen të gjitha etapat e procedurës së azilit. Nëse qëndroni në procedurën e thjeshtuar, një anëtar i personelit të Këshillit Holandez për Refugjatët do t'ju shpjegojë procedurën. Ju do të keni një avokat falas që do t'ju ndihmojë të përgatiteni për intervistën me IND-në dhe do t'ju japë këshilla ligjore.

### Hapi 5: Dëgjimi nga IND-ja

Ju zhvillonin një bisedë vetëm një herë me një punonjës të IND-së në lidhje me identitetin tuaj, shtetësinë dhe udhëtimin që keni bërë për të ardhur këtu. Kjo bisedë quhet një seancë dëgjimore. Nëse ju vini nga një vend i sigurt, atëherë bëhen gjatë kësaj bisede edhe pyetje lidhur me arsyet e kërkesës tuaj për azil. Nëse ju tashmë gëzoni mbrojtje në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, në këtë rast nuk ju bëhen pyetje lidhur me arsyet e kërkesës tuaj për azil. Nëse ju dëshironi, ju mund të kërkonit që një punonjës i refugjatëve të jetë i pranishëm në audiencë. Gjithashtu nëse dëshironi, mund t'ju kërkonit bashkëpunëtorëve të organizatës Vluchtelingen Werk të asistojnë në intervistën tuaj. Përgatituni sa më mirë të jetë e mundur për këtë seancë dëgjimi. Ju jepet vetëm një mundësi për të shpjeguar në mënyrë të qartë dhe të plotë se kush jeni dhe arsyet pse keni ardhur këtu. Gjithmonë jepni të dhënat tuaja të vërteta dhe jo ato të dokumentit (te udhëtimin) të falsifikuar. Gjithashtu tregoni nëse keni përdorur ndonjë alias (= pseudonim). Dokumentet dhe deklaratat tuaja kontrollohen për vërtetësinë e tyre. Kur IND-ja konstaton se deklaratat tuaja janë të pasakta ose dokumentet tuaja nuk janë të vërteta, kjo mund të ketë pasoja negative për aprovimin e kërkesës tuaj për azil.

Është e rëndësishme që ju të tregoni të gjitha ato nga rezultoni që ju keni nevojë për mbrojtje. Tregohuni të sinqertë, të plotë dhe të qartë në lidhje me atë që ju ka ndodhur dhe arsyet për të cilat ju nuk mund të merrni mbrojtje në vendin tuaj. Nëse një ngjarje e caktuar nuk ju kujtohet saktësisht, bëjani këtë të ditur nepunësit të IND-s. Nepunësi i IND-s është në dijeni të situatës së përgjithshme në vendin tuaj. Është e rëndësishme që ju të tregoni lidhur me situatën tuaj personale: Përse keni nevojë për mbrojtje personale. Tregoni sa më shumë detaje perkatese. Nëse keni shenja, shqetësime fizike ose psikologjike që kanë lidhje me arsyen e kërkesës tuaj për azil, është e rëndësishme që këto t'ia thoni nepunësit të IND-së. IND-ja mund të vendosë t'ju ofrojë një ekzaminim mjeko-ligjor. Por një ekzaminim të tillë ju gjithashtu mund ta bëni me iniciativën dhe shpenzimet tuaja.

Në intervistat me IND-në është një përkthyes i pranishëm. Nepunësi i IND-së i drejton pyetjet në hollandisht. Përkthyesi i përkthen- këto pyetje në një gjuhë të kuptueshme për ju. Përkthyesi përkthen përgjigjet tuaja në hollandisht. Përkthyesi është i pavarur dhe nuk ndikon në vendimin mbi kërkesën tuaj për azil. Nëse ju dhe përkthyesi nuk kuptoheni mirë me njëri-tjetrin, bëjeni të ditur menjëherë këtë. IND-ja në rast të tillë mundëson ardhjen e një përkthyesi tjetër. Është e rëndësishme që të mos lindin keqkuptime nga pikëpamja e përkthimit, nëse nuk i kuptoni pyetjet mirë.

Nëse ju keni kërkuar azil bashkë me bashkëshortin(en) ose partnerin tuaj, secili nga ju do të do të intervistohet në veçanti nga një nepunësi i IND-s. Nëse keni fëmijët mbi moshën 15 vjeç, atëherë ata gjithashtu intervistohen në veçanti. Nepermjet avokatit tuaj që ju është caktuar më parë, ju merrni një raport të seancës.

### Hapi 6: Vlerësimi i kërkesës tuaj për azil

IND shqyrton dosjen tuaj dhe të vlerëson nëse ju plotësoni kushtet për një leje qëndrimi për azil. Rezultati i këtij shqyrtimi përcakton se si do vazhdojë procedura juaj për azil.

Ka dy mundësi:

1. IND ka nevojë për më shumë kohë për punë kërkimore dhe nuk mund të vendosë mbi kërkesën tuaj për azil. IND në vazhdim e shqyrton kërkesën tuaj brenda Procedurës së Përgjithshme të Azilit. Ju japin një broshurë tjetër me informacion në lidhje me Procedurën e Përgjithshme të Azilit.
2. Kur IND-ja arrin në përfundimin që ju nuk i plotësoni kushtet për një leje qëndrimi për azil, ju dërgon nëpërmjet avokatit një letër nga IND-ja (= vendimi paraprak), ku thuhet që IND-ja planifikon që ta refuzojë kërkesën tuaj për azil. Kjo letër përmban edhe arsyet e refuzimit të mundshëm dhe çfarë pasojash ka kjo për ju. Avokati ju vë në dijeni për këtë letër dhe diskuton me ju. Në letër mund të shpallet dhe ndalimi i udhëtimin.

Një ndalim udhëtimi ju ndalon të udhëtoni ose të qëndroni në Bashkimin Evropian për kohën e përcaktuar në letër. Shkelja e këtij ndalimi për hyrjen është një shkelje penale. Vetëm azilkërkuetit me moshë madhore mund të marrin një ndalim për hyrjen.

### Hapi 7: Korrigjimet dhe plotesimet + pikepamjet

Nëse IND ka planin që ta të refuzoj kerkesen tuaj, këtë vendim të tyre paraprak duhet t'a bisedoni me avokatin tuaj. Lidhur me këtë avokati juaj ka bërë marrëveshje me ju. Në vazhdim avokati juaj pikepamjet tuaja mund t'ia dergoj me shkrim IND-s. Kjo është një letër në të cilën ju reagoni perkundrejt vendimit paraprak të IND-s. Ju mund të reagoni duke dhënë argumentat tuaja perse nuk pajtohen me planin e refuzimit të IND-s. Avokati juaj bisedon me ju gjithashtu raportin e intervistes. Edhe biseda me avokatin behet me ndermjetesimin e perkthyesit. Nëse në raport është diçka që mungon ose nuk është shkruar siç duhet, atëherë avokati juaj e raporton këtë në një letër drejtuar IND-s. Pikepamjet tuaja mbi refuzimin paraprak dhe korrigjimet dhe plotesimet e raportit të intervistës duhet t'i beni të ditura brenda dy diteve tek IND-ja.

### Hapi 8: Vendimi

Pas leximit të pikëpamjeve tuaja IND vlerëson nëse vendimi i marrë paraprakisht duhet ndryshuar. Rezultati i këtij vleresimi përcakton se si procedura juaj e azilit do zhvillohet në vazhdim. Nepermjet avokatit tuaj ju merrni një leter nga IND-ja me rezultatin e vleresimit. Avokati juaj ju shpjegon se çfarë do të thotë kjo për ju. Ka dy mundësi:

1. IND ka nevojë për më shumë kohë për punë kerkimore dhe ende nuk mund të vendosë mbi kërkesën tuaj për azil. IND në vazhdim e shqyrton kerkesen tuaj brenda Proçedurës së Përgjithshme të Azilit ose Proçedures së Zgatur. Ju japin një broshurë tjetër me informacion në lidhje me Proçedurën e Përgjithshme të Azili ose Proçedures së Zgatur.
2. IND-ja i qëndron mendimit që ju nuk i plotësoni kushtet për një leje qëndrimi për azil. Nëpërmjet avokatit tuaj ju merrni një letër nga IND-ja (= vendimi, *beschikking*), ku thuhet që kërkesa juaj për azil është refuzuar. Kjo letër përfshin po ashtu informacione të veçanta për pasojat e refuzimit, hapat që mund të merrni dhe mundësitë e hapura për ju për kthimin tuaj. Vendimi paraqet po ashtu arsyet për këtë refuzim dhe shpjegon pasojat e tij për ju. Avokati juaj do të diskutojë me ju për këtë vendim. Vendimi mund të vendosë po ashtu një ndalim për ju për hyrjen. Në një rast të tillë, do të merrni informacione të veçanta.

## Pas proçedurës së azilit

Nëse IND e refuzon kërkesën tuaj për azil, në bashkebisedim me avokatin tuaj mund të apeloni kundrejt këtij vendimi dhe ti drejtoheni një gjykate holandeze.

Nëse jeni nga një vend origjine i sigurt dhe IND-ja e refuzon aplikimin tuaj për azil, ju nuk e keni më të drejtën për shërbimet e pritjes dhe do të merrni një ndalim për hyrjen. Ju duhet të largoheni nga Holanda menjëherë. Shërbimi i Riatdhesimit dhe Largimit (DT&V) mund t'ju ndihmojë. Ju do të dërgoheni në një vend ku liria juaj do të jetë e kufizuar (VBL) ose një qendër e familjes (GL). Qendra GL është vetëm për familjet me fëmijë të mitur. Fokusi i qendrave VBL dhe GL është kthimi në vendin tuaj të origjinës. Ose do të

ndaloheni në pritje të dëbimit nëse autoritetet mund t'ju dëbojnë. Nëse nuk dërgoheni në një qendër VBL, GL ose të ndaloheni, ju duhet të largoheni nga Holanda në mënyrë të pavarur. Nëse po ktheheni në një vendi origjine të sigurt, zakonisht nuk do të merrni ndihmë financiare. As edhe nëse e tërhiqni aplikimin tuaj për azil.

Ju jeni vetë përgjegjës për kthimin tuaj në vendin e prejardhjes. Nëse ju nuk largoheni vetë, është e mundur që DT&V të kaloj në largimin tuaj të detyruar /deportimin. Nëse IND e refuzon kërkesën tuaj për azil, DT&V ju jep një broshurë me informacion lidhur me kthimin tuaj në vendin e prejardhjes. Nëse ju doni të kthehen vullnetarisht në vendin tuaj të prejardhjes, ju mund të kontaktoni Organizaten Ndërkombëtare për Migrim (IOM). IOM mund t'ju japë informacion praktik dhe mund t'ju ndihmojë në largimin tuaj. Ju mund të gjeni IOM-in në qendrat e strehimit të COA-s. Ju mund të drejtoheni me pyetje lidhur me kthimin tuaj dhe mbështetje për këtë edhe tek punonjësit e Vluchtelingenwerk ose një avokat.

## Tërheqja e kërkesës tuaj për azil

Ju mund ta tërhiqni kërkesën tuaj për azil në çdo moment që dëshironi. Në këtë rast këshillohet të merrni kontakt me një avokat, me Punonjësit Refugjatëve ose drejtpërdrejt me DT&V. Nëse e tërhiqni kërkesën tuaj për azil te IND-ja, nuk lejoheni të qëndroni më në Hollandë. Dhe në këtë mënyrë nuk keni më të drejtë për strehim. Dhe autoritetet mund t'ju lëshojnë vendimin për ndalimin e udhëtimit në këtë vend. Pas tërheqjes së aplikimit tuaj për azil, mund të aplikoni edhe një herë për azil edhe nëse është vendosur një ndalim për hyrjen për ju.

Një punonjësi i Organit Qendror të Strehimit të azilkërkesve (COA) ose VluchtelingenWerk mund t'ju sjellë në kontakt me një regjisor të DT&V-s ose ju mund të dërgoni vetë një mesazh nepermjet një formulari të posaçem i cili gjendet në faqen e internetit të DT&V: <https://www.dienstterugkeerenvertrek.nl/VertrekuitNederland/Eigenverantwoordelijkheidvreemdeling/Ikwiliterugkeren/index.aspx>

DT&V mund t'ju ndihmojë në organizimin e largimit tuaj nga Holanda. Ju vendosni vetë nëse doni ta përdorni këtë ndihmë. Nëse ju e shfrytëzoni këtë atehere ndihmoheni nga një regjisor i DT&V-s për të realizuar largimin tuaj. Regjisori dot'ju pyes se perse ju doni të largoheni në mënyrë të pavarur dhe do bisedoj me ju mundësitë e largimit tuaj nga Holanda, si biletat ajrore dhe dokumentat e udhëtimit. Më tej, regjisori i DT&V-s do t'ju tregojë mundësinë e kontaktit me Vluchtelingenwerk, ose një avokat për t'ju ndihmuar më tej në vendimin tuaj për ta tërhequr në të vertet ose jo kërkesën tuaj për azil.

Nëse ju keni një kërkesë për azil në ecje, dhe nuk keni dokumenta udhëtimi, atëherë duhet të aplikoni vetë në ambasadën ose konsullatën tuaj për dokumenta udhëtimi (zëvendësuese). Për sa kohë që kërkesa juaj për azil është në vazhdim, DT&V nuk mund t'ju ndihmojë për të aplikuar për dokumenta udhëtimi (zëvendësuese).

## Përpunimi i të dhënave tuaja personale

Të dhënat personale janë të gjitha llojet e informacioneve për ju. Organizatat që kanë bashkëpunuar për këtë broshurë janë të renditura më poshtë. Këto organizata i administrojnë të dhënat personale gjatë përpunimit të aplikimit, të njoftimit ose të kërkesës suaj. Ato ju pyesin për detajet tuaja dhe pyesin po ashtu organizata të tjera ose persona të tjerë për këto, nëse është e nevojshme. Këto organizata i përdorin dhe i ruajnë detajet tuaja dhe i transmetojnë ato tek organizatat e tjera nëse kjo kërkoet nga ligji. Legjislacioni për privatësinë përfshin detyrime për organizatat që përpunojnë të dhënat tuaja. Për shembull, ato duhet t'i administrojnë të dhënat tuaja në mënyrë të sigurt dhe me kujdesin e duhur. Ligjet për privatësinë kanë përcaktuar po ashtu të drejtat tuaja, për shembull:

- për t'u kështilluar për të dhënat që mbahen nga organizatat;
- për të ditur se çfarë bëjnë organizatat me të dhënat tuaja dhe arsyen pse;
- për të ditur se cilave organizata u janë transmetuar të dhënat tuaja.

Dëshironi të dini më shumë për përpunimin e të dhënave tuaja personale dhe të drejtat tuaja? Shikoni faqet e internetit të organizatave. Adresat e uebit mund t'i gjeni më poshtë.

## Pyetje të drejtuara shpesh

### *Kur e kam unë intervistën me IND?*

Pas regjistrimit ju do të keni brenda disa ditësh seancën e degjimit me IND. Ju keni vetëm një bisedë me IND. Kjo është ndryshe nga azilkerkues të tjerë. Kërkesa juaj për azil shqyrtohet në një procedurë të shpejtuar, sepse sipas IND ju vini nga një vend i sigurt, ose për shkak se ju tashmë keni mbrojtje ndërkombëtare në një shtet tjetër anëtar të BE-së.

### *Unë vij nga një vend origjine i sigurt. Pse mund t'i tregoj arsyet e mia për aplikimin për azil tek IND-ja në një datë më të hershme?*

Për shkak se vini nga një vend origjine i sigurt, intervista juaj do të afrohet. Ka shumë mundësi që të mos ju jepet leje qëndrimi për azilin. Në këtë mënyrë, do të ketë më shumë vende pritjeje të disponueshme për azilkerkuesit që kanë më shumë mundësi për të marrë azilin.

### *Unë historinë time të azilit e tregoj më mirë tek një grua. A është e mundur kjo?*

Në Holandë, ju nuk mund të refuzoni kontaktin me burra ose gra në jetën e përditshme. Në Shoqërinë hollandeze burrat dhe gratë trajtohen të barabartë. Këtë ne e presim edhe nga ju. Por nëse ju preferoni që motivet e azilit ti bisedoni me një nepunes të IND-s të gjinisë femerore apo mashkullore, këtë mund ta shenoni në formularet e regjistrimit tuaj. Gjithashtu, këtë ju mund t'ia thoni një punonjësi të Vluchtelingenwerk. Në këtë rast, IND përpunon të mundesojë që intervistat të zhvillohen në praninë e nepunesit të IND-s dhe perkthyesit të gjinisë femerore ose mashkullore. sipas kërkesës.

### *Çfarë duhet të bëj në qoftë se jam i sëmurë?*

Nëse jeni i sëmurë, këtë duhet t'ia thoni punonjësit të IND-s ose një punonjësi të Vluchtelingenwerk. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në qoftë se ju keni një sëmundje ngjyëse, ose mendoni të keni, të tilla si

tuberkulozi, zgjebe ose hepatit B. Gjithashtu njoftoni nepunesin e IND-s ose të Vluchtelingenwerk nëse jeni shtatzënë. Çdo gjë që ju i thoni infermieres, trajtohen në mirëbesim. Infermierja nuk ndan kurrë informacion mbi shëndetin tuaj me të tjerë pa autorizimin tuaj. Nëse sëmurëni gjatë procedurës së azilit, ju lutem për këtë njoftoni një nepunes të COA-s, të IND-s apo VluchtelingenWerk. Ata mund t'ju ndihmojnë për të marrë ndihmën (mjekësore) të duhur. Nëse jeni të sëmurë në ditën që keni një bisedë me IND apo avokatin tuaj, kërkojani një punonjësi të COA-s të lajmerojë IND ose avokatin tuaj.

### *Unë dua të kthehem vullnetarisht në vendin tim të prejardhjes*

Nëse do të ktheheni me dëshirën tuaj në vendin e origjinës, mund të merrni kontakt me Organizatën Ndërkombëtare të Emigracionit (IOM). IOM-i mund t'ju japë informacion dhe mund t'ju ndihmojë për nisjen. Mund të merrni kontakt për të mbyllur një takim të një zyrë në lagjen tuaj: 088 746 44 66 ose nëpërmjet [www.iom-nederland.nl](http://www.iom-nederland.nl). Gjithashtu mund të drejtoheni dhe te DT&V për informacion. Edhe mbas procedurës së azilit mund t'i drejtoheni PunësmeRefugjatët për mbështetje dhe informacion. A keni ardhur nga një vend i sigurt dhe do të ktheheni me dëshirën tuaj? Atëherë në shumicën e rasteve nuk do të merrni ndihmë financiare për kthimin me dëshirën tuaj. Gjithashtu edhe kur e tërhiqni kërkesën për azil.

### *Dëshiroj të kthehem në vendin tim të origjinës. Si mund ta marr pashaportën mbrapsht?*

Ndërkohë nëse doni të udhëtoni dhe doni t'ia merrni mbrapsht dokumentat e identitetit, sepse p.sh. dëshironi të ktheheni, për këtë duhet të njoftoni tek DT&V. DT&V pyet IND-në për kthimin e dokumentave. IND-ja ja dërgon dokumentat mbrapsht DT&V. Më pas dokumentat ju dorëzohen në momentin real të nisjes tuaj. Vetëm dokumentat autentike të udhëtimit dhe të identitetit tuaj ju dorëzohen mbrapsht.

### *Çfarë ndodh me azilkerkuesit që shkaktajnë shqetësime?*

Qeveria holandeze pret një sjellje të mirë nga ju dhe nga çdo shtetas tjetër i huaj. Po shkaktoni një shqetësim në ose pranë qendrave të pritjes gjatë ose pas procedurës suaj të azilit? Kini parasysh se mund të merrni hapa të menjëhershëm. Këta mund të përfshijnë vendosjen e një ndalimi për zonën ose vendosjen në ndalim imigrimi. Një gjykatë mund të vendosë po ashtu një dënim me burgim.

### *Mbas leximit të këtij publikimi, keni pyetje ende në lidhje me procedurën?*

Ju mund t'ia drejtoni këto pyetje një prej punonjësve të IND-s, avokatin tuaj ose një punonjësi të VluchtelingenWerk.

### *Keni ndonjë ankesë?*

Të gjitha organizatat e përfshira në procedurat e azilit, punojnë në mënyrë profesionale dhe me kujdes. Nëse ju gjeni se ju nuk trajtohen mirë nga një organizatë, ju mund të paraqesë një ankesë. Avokati juaj ose një punonjësi i refugjatëve mund të ndihmojë.

**Ky publikim është një botim i përbashkët i:**

Centraal Orgaan opvang asielzoekers | [www.coa.nl](http://www.coa.nl)  
Dienst Terugkeer en Vertrek | [www.dienstterugkeerenvertrek.nl](http://www.dienstterugkeerenvertrek.nl)  
Immigratie- en Naturalisatiedienst | [www.ind.nl](http://www.ind.nl)  
Raad voor Rechtsbijstand | [www.rvr.org](http://www.rvr.org)  
VluchtelingenWerk Nederland | [www.vluchtelingenwerk.nl](http://www.vluchtelingenwerk.nl)

Me porosi të:

Ministrisë së Drejtësisë dhe Sigurisë, Drejtoria Politikë e Migrimit  
[www.rijksoverheid.nl](http://www.rijksoverheid.nl)

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Nwse përkthimi mund të shkaktojë dallime në interpretim,  
atëherë versioni në hollandisht është vendimtar.